



PK. SH.A.
Posta e Kosovës SH.A.
Post of Kosovo J.S.C.
Pošta Kosova D.D.

Nr./No./Dr. 01-40/26
Data/Date/Datum 13-01-2026
PRISHTINE-PRISTINA-PRISTINA

RREGULLORE PER NDRYSHIM/PLOTESIM TE RREGULLORES NR. 01-1974/17 TË DATËS 27.07.2017 PËR SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË NIVEL QENDROR

Janar 2026

Në bazë të nenit 20 të Ligjit Nr-04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087 për Ndërmarrje Publike, Bordi i Drejtorëve në mbledhjen nr.01/26 të mbajtur më datë 09/01/2026, sipas vendimit nr. 05/26 miraton këtë:

RREGULLORE PËR NDRYSHIM/PLOTËSIM TE RREGULLORES NR. 01-1974/17 TË DATËS 27.07.2017 PËR SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË NIVEL QENDROR

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr.01-1974/17 të datës 27.07.2017 për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Nivel Qendror (tani e tutje “Rregullorja bazike”).

Neni 2 Fushëveprimi

Fushëveprimi i kësaj rregulloreje është i njëjtë sikurse fushëveprimi i rregullores bazike.

Neni 3

1. Neni 11 paragrafi 2 i Rregullores nr.01-1974/17 të datës 27.07.2017 për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Nivel Qendror pozita e punës “Shef/e i/e Zyrave Postare” fshihet tërësisht nga rregullorja.
2. Neni 13 paragrafi 2 i Rregullores nr.01-1974/17 të datës 27.07.2017 për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Nivel Qendror pozita e punës “Shef/e për Administratë dhe Protokoll” fshihet tërësisht nga rregullorja.

Neni 4 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Bordi i Drejtorëve të PK Sh.A.

